




REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SER. JF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Prijmëno / Prodato Received / Delivered	15-01-2021	2021	1	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinstvo Org / Unit	Nr. Prot Br. Prot Prot No	Shtesa a Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SHMBHQ	165/2021		1/4	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.385/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë, si dhe Clirim Zeka, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.385/2020 të datës 03.12.2020, të parashtruar nga ankuesi _____ me adresë Rr. "Zija Shemsiu" U-3, H-3, Nr. 20, Prishtinë, kundër organit të punësimit-Ministria e Drejtësisë, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, të mbajtur me datë 15.01.2021, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës shpallet jo kompetent për të vendosur për ankesën me numër A.nr.385/2020 të datës 03.12.2020, e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi _____ i punësuar në pozitën "Hetues Mjekësor i Vdekjes", në Institutin e Mjekësisë Ligjore, në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, me datë 03.12.2020, ka parashtruar ankesë me numër protokoll 2913/2020 e regjistruar me numër A.nr.385/2020, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin që Këshilli të shqyrtoj dhe vlerësoj veprimet dhe vendimet e ndërmarra lidhur me shuarjen e pozitës "Hetues Mjekësor i Vdekjes", sipas Rregullores MD Nr.01/2020 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Institutit të Mjekësisë Ligjore.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave, me datë 13.01.2020 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Ministrisë së Drejtësisë. Këshilli po me datë 21.12.2020, ka pranuar përgjigje në ankesë nga Ministria e Drejtësisë, se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e datës 03.12.2020 me Nr.Prot:2913/2020 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 13.01.2021; Përgjigjen në ankesën e datës 13.01.2021 nga Udhëheqësja e Divizionit të Burimeve Njerëzore për ankuesin; Përgjigjen e datës 26.11.2020 me nr. të protokollit 09-588/3; Kërkesën për ligjshmërinë e rregullores MD-Nr. 01/2020 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e Institutit të Mjekësisë Ligjore nga ankuesi e datës 26.11.2020; Peticionin për pezullimin e procedurës së hyrjes në fuqi të Rregullores me nr. 01/2020 i datës 03.08.2020; Përmbledhjen e procesverbalit të takimit i datës 03.08.2020; Peticion nga zyrtarët e Institutit të Mjekësisë Ligjore; Reagimin për draft raportin e Vlerësueses së BE-së lidhur me Projektin IPA2 i datës 06.06.2019; Komunikatën për media e datës 20.11.2020; Vendimin e datës 04.03.2020 nga Sekretari i Përgjithshëm i MD-së; E-mailin nga N.U për F.D të datës 07.07.2020; Kërkesën për pezullimin e procedurës së hyrjes në fuqi të Rregullores me nr. 01/2020 e datës 13.07.2020; E-mailin nga B. Zh. për N.Sh. i datës 14.08.2020; E-mailin nga D.K për B.G. i datës 11.08.2020; E-mailin nga B. G. për I.M i datës 10.08.2020; E-mailin nga I.M për B.G. i datës 08.08.2020; E-mailin nga B.G. për I.M i datës 07.08.2020; E-mailin nga I. M për B.G. i datës 07.08.2020; E-mailin nga E. H për A.B i datës 02.06.2020; E-mailin nga I. M për B.G i datës 07.08.2020; E-mailin nga B.G për N.Sh i datës 05.08.2020; E-mailin nga N.Sh për D.K i datës 05.08.2020; E-mailin nga D.K për N.SH i datës 04.08.2020; E-mailin nga M. Gashi për A.Gi datës 30.11.2018; Kërkesën për plotësim/ndryshim të Rregullores MD-Nr.01/2020 për Organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e Institutit të Mjekësisë Ligjore i datës 12.10.2020; Komentet lidhur me Rregulloren MD-Nr.01/2020 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e Institutit të Mjekësisë Ligjore; Vendimin e datës 04.03.2020; Reagimin për Draft Raportin e Vlerësueses së BE-së lidhur me Projektin IPA2 i datës 06.06.2019; E-mailin nga B. ZH për M.B i datës 25.06.2019; E-mailin nga B.ZH për A. G i datës 23.11.2018; E-mailin nga B. ZH për A.G. i datës 06.12.2018; E-mailin nga B.ZH për A. G datës 06.12.2018; E-mailin nga F. B për N. Uka i datës 12.05.2018; E-mailin nga N. U për B. ZH i datës 05.12.2018; E-mailin nga për B.Zh i datës 05.12.2018; E-mailin nga F. D për B. ZH i datës 05.12.2018; E-mailin nga B.ZH për M.G i datës 04.12.2018; E-mailin nga D. K për S.S i i datës 06.07.2020; E-mailin nga A.N për Ç. Z datës 13.01.2021; E-mailin nga Ç.Z për A. N i datës 13.01.2021; Kontratën e Punës se datës 01.06.2017; E-mailin nga N.B për A.B i datës 02.06.2020; E-mailin nga E. H për A.B i datës 02.06.2020; Vendimin e datës 04.03.2020; E-mailin nga E. A për F. P i datës 15.04.2020; E-mailin nga F. P për R. N i datës 14.04.2020; E-mailin nga N.B për A.G i datës 14.04.2020; Pika 3 Sqarim; E-mailin nga N.R për F. Pi datës 16.04.2020; E-mailin nga F. P për R.N i datës 14.04.2020; Skema Organizimit të Brendshëm të Institutit për Mjekësi Ligjore; Konkurs i datës 16.03.2017; Rregullore MD-NR.01/2020 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Institutit të Mjekësisë Ligjore; E-mailin nga A.B për A.N i datës 06.01.2021; E-mailin nga B.Z për M. SH i datës 06.01.2021; E-mailin nga M.SH për B.Z i datës 08.01.2021; E-mailin nga B. Z për A. B i datës 08.01.2021.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës, të parashtruara nga palët, ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës, është jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.385/2020 të datës 03.12.2020, e parashtruar nga ankuesi sepse;

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kërkon që Këshilli të shqyrtoj dhe vlerësoj veprimet dhe vendimet e ndërmarra lidhur me



shuarjen e pozitës "Hetues Mjekësor i Vdekjes", sipas Rregullores MD Nr.01/2020 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Institutit të Mjekësisë Ligjore.

Kolegji nga shqyrtimi i shkresave të lëndës ka gjetur se ankuesi mban pozitën e punës "Hetues Mjekësor i Vdekjes" në kuadër të Departamentit të Mjekësisë Ligjore, sipas Kontratës së Punës të datës 01.12.2010.

Ministria e Drejtësisë ka aprovuar Rregulloren MD Nr.01/2020 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Institutit të Mjekësisë Ligjore, rregullore kjo e publikuar në Gazetën Zyrtare më datë 03.07.2020. Me Rregulloren MD Nr.01/2020 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Institutit të Mjekësisë Ligjore është shuar Njësia e Hetuesve të Vdekjes, në kuadër të së cilës ka qenë i sistemuar ankuesi në pozitën Hetues Mjekësor i Vdekjes.

Më datë 26.11.2020 ankuesi i është drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Drejtësisë, më bazë të njëjtë ankimore, ndërsa me datë 30.11.2020, Menaxherja e Personelit të Ministrisë së Drejtësisë, ka njoftuar ankuesin lidhur me të drejtën e tij që të parashtrojë ankesë drejtpërdrejtë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovë, apo Inspektoratin e Punës.

Në kuptim të përcaktimit të kompetencës së Këshillit për vendosje të ankesës, Kolegji ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.05/L-060 për Mjekësinë Ligjore përkatësisht nenin 14 paragrafi 1, i cili ka përcaktuar se: *Instituti i Mjekësisë Ligjore themelohet si organ qendror i administratës shtetërore, në vartësi të Ministrisë së Drejtësisë, si dhe nenin 16 ku parashihet se: "Organizimi i brendshëm dhe sistematizimi i Institutit, rregullohet me akt të veçantë, të cilin e miraton Ministri i Drejtësisë në pajtim me Ligjin për administratë shtetërore. Ky akt përfshihet si kre i veçantë në Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të Ministrisë së Drejtësisë.*

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave lidhur me statusin e organizimit të Institutit të Mjekësisë Ligjore, ka analizuar Rregulloren Nr.01/2020 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Institutit të Mjekësisë Ligjore, dhe duke iu referuar pjesës hyrëse të rregullores, Kolegji ka gjetur se Rregullorja Nr.01/2020 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Institutit të Mjekësisë Ligjore është nxjerr duke u bazuar në dispozitat e nenit 13 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, e me të cilin nen është përcaktuar se: *"1. Administrata e shërbimeve publike është përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve drejtpërdrejtë për qytetarët, në pajtim me ligjin. 2. Administrata e Shërbimit Publik organizohet si një njësi e Shërbimit Publik apo si një institucion i Shërbimit Publik. 3. Njësia e Shërbimit Publik apo institucioni i Shërbimit Publik themelohet, organizohet, funksionon dhe shuhet sipas ligjeve të veçanta sektoriale, që rregullojnë atë shërbim publik. 4. Veprimtaria e njësive të Shërbimit Publik drejtohet dhe bashkërendohet nga ministria apo një agjenci ekzekutive përgjegjëse.*

Po ashtu, Departamenti për Reformën në Administratë Publike dhe Integritet Evropian në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, përmes e-mailit zyrtar të datës 02.06.2020 dhe 08.08.2020, ka konfirmuar se Instituti i Mjekësisë Ligjore organizohet sipas nenit 13 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura.

Andaj, duke u bazuar në përcaktimin si me lartë lidhur me statusin e organizimit të Institutit të Mjekësisë Ligjore, Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave konstaton se sipas rregullativës ligjore në fuqi pozita e ankuesit nuk konsiderohet pozitë e nëpunësit civil por pozitë e nëpunësit të shërbimit publik siç parashihet me neni 2 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë ku



përcaktohet se: *Nëpunës i Shërbimit Publik është personeli i nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike, pjesë e administratës shtetërore apo në administratën e shërbimeve publike, pjesë e një komune të cilët ofrojnë shërbime publike të drejtpërdrejte për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit si dhe shërbime tjera të ngjashme publik, në këtë kuptim rrjedhë se Këshilli nuk është kompetent për të vendosur për ankesën e ankuesit*

sepse bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nen paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli është kompetent për të vendosur vetëm për nëpunësit civil dhe kandidatet për praninë në Shërbimin Civil, respektivisht për zyrtarët publikë të përcaktuar në nenin 2 paragrafi 2 nen paragrafi 2.1 dhe paragrafi 3 si dhe nenin 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas shtjellimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.385/2020

Clirim Zeka

Zeka
Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Institutit të Mjekësisë Ligjore;
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Drejtësisë;
- Arkivit të KPMSHCK-së.

